



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 06 Mars 2022

Nr: 14

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 07, DATË 05.03.2022, DEPOZITUAR  
NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në mbledhjen e datës 06.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Avokati Marash Logu

**OBJEKT:** Kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 171, datë 05.03.2022, të KZAZ-së nr. 26

**BAZË LIGJORE:** Bazuar në nenet 21, 123/1, 124, 124/1 dhe 126, neni 160, pika 2 dhe 3, neni 161, pika 1 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

### **Rrethanat e çështjes:**

- Me vendimin nr. 130, datë 05.03.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (*më tej KSHZ*) ka vendosur të miratojë listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve, të KZAZ-së nr. 26, bashkia Vorë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit.
- KSHZ në vendimin e tij urdhëron KZAZ-në që administron procesin në këtë zonë zgjedhore, të emërojë kryesisht anëtarë të KQV-ve deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, duke përzgjedhur shtetas nga lista e miratuar.
- Me vendimin nr. 171, datë 05.03.2022, KZAZ nr. 26, me shumicë votash ka vendosur të mos miratojë anëtarët e KQV-ve pjesë e listës shumëmemërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht sipas Lidhjes Nr. 1 të vendimin nr. 130, datë 05.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Partia Demokratike e Shqipërisë, më datë 05.03.2022 ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor kundër vendimit nr. 171, datë 05.03.2022 të KZAZ nr. 26, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe zbatimin e vendimit nr. 130, datë 05.03.2022 të KSHZ-së.
- KAS-i caktoi me short relatorin z. Ledio Braho dhe në mbledhjen e datës 06.03.2022, pranoi për shqyrtim dhe shqyrtoi në themel ankimin, me praninë e ankuesit dhe të administratës së KQZ-së, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në përfundim të seancës së pyetjeve dhe pasi dëgjoi pretendimet e palëve,

### **KAS-i konstaton se:**

- KZAZ Nr. 26 Bashkia Vorë, me anë të vendimit nr. 170, datë 05.03.2022 ka vendosur “*Të mos regjistrojë si Kandidatë për Komisionet e Qendrave të Votimit 104 Kandidatët për kryetarë, sekretarë dhe anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit. Të njoftojë me shkresë zyrtare Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*”. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar e drejta ankimit nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë apo nga ndonjë palë tjetër.
- Neni 36 i K.Zgjedhor, në pikat 4 dhe 5 të tij parashikon se:

*“Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KQV-së mbetet vakant, ai plotësohet brenda 3 ditëve, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit. Zëvendësimi i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve ose që nuk paraqiten në detyrë në ditën e zgjedhjeve, bëhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës.*

**5. Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak të mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk është kryer zëvendësimi, sipas pikës 4, KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës. KQV-ja bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të saj dhe procedon me zbatimin e detyrave, pavarësisht nga kuorumi”.**

- Po ashtu, Komisioni Rregullator me Udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”, në nenin 11 pikat 5 dhe 7 të tij, ka përcaktuar se:

*“5. Komisioneri, miraton me vendim listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante për anëtar dhe sekretar të KQV-së, sipas parashikimeve të nenit 36 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*

...

*7. Komisioneri i dërgon KZAZ përkatëse listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësim të vakancave në KQV-të e qendrave të votimit në juridiksionin e saj”.*

- Në nenin 12 pika 1 të po këtij udhëzimi parashikohet se “Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për plotësimin kryesisht të vakancës në KQV në juridiksion territorial të Zonës së Administrimit Zgjedhor emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së, sipas rastit, me emrat nga lista e miratuar me vendim të KQZ-së”. Ndërkohë, në pikat 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohet në mënyrë të detajuar mënyra e hedhjes së shortit nga KZAZ për plotësimin e këtyre vakancave sipas listës së miratuar nga KSHZ.
- Në vendimin e KZAZ objekt shqyrtimi administrativ është arsyetuar se “KZAZ Nr. 26 Bashkia Vorë, pasi u njoh me shkresën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ku shprehet për zbatimin e Kodit Zgjedhor dhe kompetencave që i jep ligji KZAZ për emërimin e komisionerëve të KQV. Nisur nga lidhja nr. 1, lista emërore e vendosur kryesisht nga KQZ paraqitur me shkresën nr. 1582, datë 05.03.2022 është po e njëjta listë emërore që subjekti

*Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur për t'i emëruar si anëtarë, sekretarë dhe kryetarë të KQV*".

- Është e vërtetë që sipas neneve 33 shkronja “b” dhe 36 pika 5 të K.Zgjedhor, emërimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KQV është kompetencë e KZAZ përkatëse që i ka nën juridiksion, por në rastin objekt shqyrtimi jemi në kushte *sui generis*, ku ligjvënësi ka autorizuar Komisionin Rregullator pranë KQZ, në zbatim të nenit 20 pika 1 shkronja “a” të K.Zgjedhor që parashikon se *“1. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për:*

*a) rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje”* për të detajuar procedurat e përzgjedhjes të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në Komisionet e Qendrave të Votimit. Pikërisht në zbatim të këtij autorizimi të ligjvënësit, Komisioni Rregullator ka miratuar edhe udhëzimin nr. 2, datë 05.12.2020, i cili për rastin e vakancave të krijuara në zbatim të nenit 36 pika 5 të K.Zgjedhor, ka ngarkuar me kompetencë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për të miratuar listën e këtyre shtetasve që mund të emërohen kryesisht si anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve, ndërkohë që KZAZ i ka ngarkuar vetëm kompetencën e organizimit të shortit publik për përzgjedhjen e anëtarëve nga lista shumemërore e miratuar nga KSHZ. Për rrjedhojë, verifikimi i plotësimit të kushteve për emërimin kryesisht si anëtar apo sekretar i KQV-së, në këtë rast, është kompetencë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe jo e KZAZ-së që ka nën juridiksion KQV-të përkatëse. Më konkretisht, kjo kompetencë e KSHZ në lidhje me verifikimin e plotësimit të kushteve për emërimin kryesisht si anëtar dhe sekretar i KQV, parashikohet edhe në pikat 1 dhe 2 të nenit 11 të udhëzimit nr. 2, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator që më konkretisht përcakton se:

*“1. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2, shkronja “c”, administrata e KQZ-së kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të dhënat e shtetasve të interesuar për t’u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KQV-ve.*

*2. Objekti i verifikimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është verifikimi i dokumentacionit të paraqitur sipas parashikimeve të nenit 10, paragrafi 2 të këtij udhëzimi si edhe plotësimi i kushteve të përcaktuara në nenin 8 dhe 9 të këtij udhëzimi”.*

Si përfundim, nga të gjitha dispozitat e parashikuara në K.Zgjedhor apo dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, duket qartë që KZAZ nuk ka kompetenca për verifikimin e plotësimit të kushteve për t'u emëruar kryesisht anëtar apo sekretar KQV.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e Kërkesës Ankimore nr. 07, datë 05.03.2022 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë;
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 171, datë 05.03.2022, të KZAZ-së nr. 26;
3. Detyrimin e KZAZ nr. 26 të bëjë emërimin e sekretarëve dhe anëtarëve të KQV-së, për ato KQV që kuorumi nuk plotësohet, sipas listës bashkëlidhur vendimit nr. 130, datë 05.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>